



Merr frymë shirë

Kosova pa tym duhani prej

22

Maj 2013

www.kadc-ks.org



Ky projekt/aktivitet është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

E MËRKURË 22 MAJ 2013



**NDALOHET
PIRJA E DUHANIT**
PIRJA E DUHANIT NË KËTË HAPËSIRË ËSHTË E NDALUAR ME LIGJ

RAPORTO SHKELJEN E LIGJIT NË
0800 11 000

SHKELJA E LIGJIT GJOBITET

50C Personi fizik
500C Personi përgjegjës në hapësirën
3000C Personi juridik - subjekti afarist

Hapësirë për të marrë frymë për të gjithë në Kosovë

Nga dita e mërkurë 22 Maj 2013 në të gjitha vendet publike të mbyllura, në vendet e punës dhe në mjetet e transportit publik në Kosovë ndalohet pirja e duhanit me Ligj.

Ku është e ndaluar pirja (tymosja) e duhanit?

- 🚫 Hapësira publike (të mbyllura)
- 🚫 Hapësira të punës
- 🚫 Mjetet e transportit publik
- 🚫 Hapësirat e përbashkëta të ndërtesave me banesa shumëkatëshe
- 🚫 Hapësira publike të hapura që janë në administrim të institucioneve edukative - arsimore (p.sh. oborre, kopshte etj.)
- 🚫 Afërsi të hyrjeve/daljeve të hapësirave publike (të mbyllura), hyrjeve/daljeve të hapësirave të punës dhe të hyrjeve/daljeve të institucioneve shëndetësore, vendet e lojërave për fëmijë, stadime, arena apo hapësirave për çfarëdo shfaqje

Çfarë mund të bëni Ju?

Shenjat “Ndalohet pirja e duhanit” duhet të vendosen në vendet publike të mbyllura dhe në mjetet e transportit publik. Nëse e shihni ndonjë person duke pirë (tymosur) duhan ose nëse shenja “Ndalohet pirja e duhanit” nuk është e vendosur në vendet e cekura më lartë informoni personin përgjegjës për hapësirën. Nëse çështja prapë nuk zgjidhet, shkeljen e Ligjit mund ta lajmëroni pa pagesë në Tel. **0800-11-000**

Kush është personi përgjegjës për hapësirën dhe cilat janë detyrat e tij?

Personi përgjegjës për hapësirën mund të jetë udhëheqësi, pronari, menaxheri, apo personi tjetër përgjegjës për hapësirën publike të, mbyllur, të hapur, hapësirën e punës, mjetet e transportit publik dhe ka për detyrë të:

- 🚫 Vendos shenjat “ndalohet pirja e duhanit dhe vlera e dënimit” në bazë të formatit, përmbajtjes, dizajnit, madhësisë, dukshmërisë, vendit dhe të gjitha materialet e tjera të përcaktuara me akt nënligjor nga Ministria e Shëndetësisë
- 🚫 Largoj të gjitha taketuket nga hapësirat e mbyllura ku ndalohet pirja e duhanit
- 🚫 Mbikëqyrë respektimin e ndalimit të pirjes së duhanit
- 🚫 Ndërmerr hapa për të parandaluar pirjen e duhanit në vendet ku është e ndaluar, duke kërkuar nga personi që të mos pijë duhan, të mos i ofroj shërbim, të kërkoj që personi të largohet nga lokalet apo transporti publik kur është e sigurt që kjo të bëhet, dhe të kontaktoj organet përkatëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit

Cilat janë ndëshkimet për shkelje të Ligjit?

- 🚫 Nëse ju shkelni Ligjin duke pirë duhan në një vend publik, vend të punës, mjet të transportit publik apo vende tjera ku ndalohet pirja e duhanit, ju dënoheni me gjobë prej **50 euro**
- 🚫 Nëse ju shkelni Ligjin duke pirë duhan në vend të punës, punëdhënësi iu zbrit **50 euro** nga paga mujore
- 🚫 Nëse personi përgjegjës për hapësirën nuk vendos shenjën “Ndalohet pirja e duhanit” ose lejon ndonjë person të pijë duhan në vend publik, vend të punës, mjet të transportit publik apo hapësirë tjetër të cilën e zotëron ose menaxhon, dënohet me gjobë prej **500 euro**
- 🚫 Personi juridik-subjekti afarist për shkeljen e mësipëme dënohet me gjobë prej **3000 euro**

Shenjat “Ndalohet pirja e duhanit” dhe udhëzuesi për zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit, do të jenë në dispozicion për shkarkim pa pagesë në www.kadc-ks.org dhe www.msh-ks.org

Kush do të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit?

Zbatimin e këtij Ligji e kryejnë inspektorët qendror e komunal dhe organet e tjera, si Inspektor Sanitarë, Inspektor Shëndetësor, Inspektor të Tregut, Inspektor të Punës, Inspektor të Arsimit, inspektor të Transportit, Agjencioni kundër Korrupsionit dhe Policia e Kosovës.

FAKTE RRETH DUHANPIRJES PASIVE

Çka është tymi i dorës së dytë?

Tymi i dorës së dytë nënkupton përzierjen e tymit i cili lirohet nga djegia e duhanit dhe tymit që lirohet nga mushkëritë e personit që tymos duhanin. Tymi i dorës së dytë përmban rreth 4000 substanca helmuese duke përfshirë edhe 69 substanca që shkaktojnë kancer.

Cilat janë rreziqet për shëndetin nga tymi i dorës së dytë?

Tymi i dorës së dytë nuk irriton vetëm sytë, hundën dhe fytyrën, tani është shkencërisht e vërtetuar që shkakton:

- **Kancerin e mushkërive, fytyrës dhe gojës**
- **Infarkt në zemër**
- **Sulmin në tru**
- **Astmën**
- **Sëmundjet kronike të mushkërive**

A është më pak i rrezikuar shëndeti i personit që nuk tymos duhan por qëndron në mjedis me tym duhani?

Personi i cili i ekspozohet tymit të duhanit në një mënyrë është i detyruar që pa vullnetin e tij të thithë këtë tym (duhanpirës pasiv) dhe është i rrezikuar në masë të njëjtë nga kanceri dhe sëmundjet e zemrës sikurse edhe personi që tymos duhanin në mënyrë aktive.

Tymi i dorës së dytë dhe ajrosja

Nuk ekziston nivel i sigurt i ekspozimit ndaj substancave helmuese që vijnë nga tymi i dorës së dytë dhe 85% e tyre janë të pa dukshme dhe pa erë. Hapja e dritareve apo përdorimi i sistemit të ajrosjes nuk eliminon të gjitha substancat e rrezikshme që gjenden në tymin e dorës së dytë. Do të duhej një ventilim me fuqinë e një tornadoje për të larguar të gjitha substancat e rrezikshme për shëndetin.